



Data: 29/07/2019

Ref.: 1380/190

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 73-të dhe 74-të, të mbajtur më 19.06.2019 dhe 15.07.2019, mori:

#### V E N D I M

- I. Akreditohet programi i studimit të Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” për periudhën tri vjeçare, 1 tetor 2019 – 30 shtator 2022:
  - Shkenca e Ushqimit, MSc 120 ECTS, maksimumi 40 studentë për vit akademik.
- II. Nuk akreditohet programi i studimit të Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”:
  - Bujqësi Urbane, MSc 120 ECTS
- III. Obligohet Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” që deri me datë 1 tetor 2019 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final të ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit mbi akreditimin e programit Shkenca e Ushqimit, MSc.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

#### Arsyetimi

I. Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për akreditim të programeve të studimit të cekura në dispozitivin të këtij vendimi.

AKA ka organizuar vizitën me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë më datë 25.04.2019 me qëllim të vlerësimit në nivelin institucional dhe të programeve të studimit me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit më këtë përbërje: Prof. Dr. Joachim Muller, Prof. Dr. Reiner Doluschitz.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mledhjen e mbajtur më 19.06.2019 dhe 15.07.2019 ka shqyrtuar aplikacionin e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtar të dhënë në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Raporti i ekspertëve ndërkombëtar konstaton se programi i studimit Shkenca e Ushqimit (MSc) i ofruar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë përmbushë substancialisht standardet e akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit.


Sa i përket programit të studimit Bujqësi Urbane, MSc, ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit, kanë konstatuar se ky program i studimit plotëson pjesërisht kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit. Ndër mangësitë kryesore të cilat kanë qar në mos dhënien e rekomandimit për akreditim, sipas ekipit të ekspertëve është mungesa e një të kuptuari të qartë nga stafi i fakultetit, studentët potencial të programit në fjalë, të diplomuarit dhe punëdhënësit se çfarë është “bujqësia urbane”. Qëndrimi i ekspertëve është se hapja e një programi të ri të tillë kërkon udhëheqës me përvojë në këtë fushë, mirëpo në CV-të dhe të dhënat për stafin mësimdhënës nuk janë gjetur publikime nga fusha e bujqësisë urbane. Ata kanë shtuar se në procesin e ardhshëm të vlerësimit bartësit e programit duhet të jenë në gjendje të prezantojnë një koncept të pjekur dhe të menduar mirë për programin e studimit. Sa i përket hulumtimit, ekipi i ekspertëve ka gjetur se pjesa më e madhe e punimeve publikohen si prezantime në konferenca dhe kryesisht në revista rajonale. Nuk janë gjetur dëshmi të punimeve shkencore në fushën e bujqësisë urbane të publikuara nga stafi. Si përfundim ekipi i ekspertëve ka deklaruar se programi Bujqësi Urbane MSc është prezantuar në gjendje të pa finalizuar mirë dhe si i tillë nuk i përmbushë standardet e akreditimit.



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



---

Prof. Dr. Gazmend Luboteni  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

